Planvendosja e marrjes ne perdorim e tokes shteterore, bazuar mbi LIGJIN 20/2025, Neni 4
"PAKETA MALEVE", Zona kadastrale 3633, Numri pasurise140/1/4, NJESIA ADMINISTRATIVE TREGAN




## TE DHENA TE PERGJITHSHME

| | |
|---|---|
| Emertimi Objektit : | Planvendosja e marrjes ne perdorim e tokes shteterore, bazuar mbi LIGJIN 20/2025, Neni 4 "PAKETA MALEVE" |
| Zhvilluesi: | KRESHNIK ÇELA & MATILDA LUMA |
| Proner i prones: | Pasuria 140/1/4 |
| Adresa: Njesia Administrative TREGAN | |
| Pasaporta | Nr.348 |
| Kodi Njesise Strukturore | 11/48 |

Zona Kadastrale 3633 , Numri pasurise 140/1/4,

Referuar ligjit 20/2025 "Paketa Maleve", kerkoj marrjen ne perdorim te nje sipertaqe sip= 4000m², pjese te pasurise se ndodhur ne zona kadastrale 3633 , numri pasurise 140/1/4, e cila figuron prone shtet.
Kete siperfaqe e kerkoj ne mbeshtetje te biznesit te cilin po e strukturoj ne objektin 4-kat me funksion hoteleri dhe sherbim social-ekonomik i cili eshte me numer pasurie 140/1/5 i cili ndodhet ne zonen kadastrale 3633, te cilin e posedoj me dokument pronesie .

**Siperfaqa Sip = 4000m²**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emertimi Objektit : Planvendosja e marrjes ne perdorim e tokes shteterore, bazuar mbi Ligjin 20/2025, Neni 4 "PAKETA MALEVE" | | | |
| Zhvilluesi: KRESHNIK ÇELA & MATILDA LUMA | | | |
| Proner i prones: Pasuria 140/1/4 | | | |
| Adresa: Njesia Administrative TREGAN | | | |
| Emertimi i fletes: | | PLANVENDOSJE | |
| Arkitektura | ark.Marvis Avllazgaj | A 0.992/2 | |
| | | | |
| Planvendosja Sh 1:500 | | | Fleta : F01 |

HARTA KADASTRALE SH 1:500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. 1823 Prot. Elbasan, më 02 . 04. 2026

*Lënda:* **Njoftim për afishimin publik në faqen Web dhe këndin e njoftimeve publike.**

- **SEKTORIT I IT, BASHKIA ELBASAN**
- **NJËSIA ADMINISTRATIVE TREGAN**

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve",
- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- VKM nr. 625 datë 28.10.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan",
- Udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkive",
- Urdhërit nr 1003 datë 19.11.2025 Për ngritjen e grupeve të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjketeve të ndryshëm kërkues,për tu njohur si "posedues Jopronar"
- Kërkesës së paraqitur nga portali e-albania nga z. Kreshnik Çela

Kërkojmë të bëhet afishimi publik me afat 45 (dyzet e pesë) ditor, bazuar në Ligjin Nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", neni 10 pika 1 e cila ndër të tjera thotë *... për pasuritë apo pjesët e tyre që përmbushin kushtet, bashkia kryen njoftimin me afishim publik për 45 (dyzet e pesë) ditë në ambientet e saj, në një vend tjetër publik brenda territorit të zonës, si dhe në faqen zyrtare të saj të internetit. Afishimi përmban listën e subjekteve me sipërfaqet respektive, përshkrimin e vendndodhjes së tyre dhe shoqërohet nga planet e rilevimit përkatëse*. Për sa më sipër kërkojmë që të merrni masat të bëhet afishimi pranë këndit të njoftimeve të njësisë Administrative Tregan, në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan si dhe në këndin e njoftimeve të Bashkisë Elbasan.

Planvendosja e pretenduesit të z.Kreshnik Çela ndodhet në njësinë administrative Tregan në vendin e quajtur Llixha nr pasurie 140/1/4 zk 3633 me një sipërfaqe prej 4,000 $m^2$.*(Bashkangjitur plan vendosja)*Me përfundimin e afatit 45 ditor, duhet të përcillet procesverbali i mbajtur nga personi përgjegjës për afishimin, ku citohet përfundimi i afatit të afishimit, si dhe, nëse ka pasur ankesa apo jo lidhur me pasurinë në objekt trajtimi, në mënyrë që të vijojë me procedurën.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

**K R Y E T A R I**
**Gledian Llatja**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Asim Sula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN